



Data: 22.02.2019

Ref.: 346/1910

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

## V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit Iliria, (Nr.1485/18H, datë 31.10.2018) për akreditim dhe riakreditim të programeve të studimit si më poshtë:
  - Inxhinieri Softverike, MSc, 120 ECTS;
  - Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS;
  - Infermieri, BA, 180 ECTS, dhe
  - Inxhinieri Civile, MSc, 120 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Kolegji Iliria ka parashtruar kërkesë (Nr.1485/18H, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për akreditim dhe riakreditim të programeve të studimit si në vijim: Inxhinieri Softverike, MSc, 120 ECTS; Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS; Infermieri, BA, 180 ECTS; Inxhinieri Civile, MSc, 120 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS; Juridik Penal, LLM, 60 ECTS; Juridik Civil, LLM, 60 ECTS; Shkenca Kompjuterike – Informatikë e Aplikuar, BSc, 180 ECTS, dhe Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit Iliria. Bazuar në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, ku thuhet: *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti*

1/2

*përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”.*

Mbi këtë bazë, KShC erdhi në përfundim se programet e studimit të Kolegjit Iliria, Inxhinieri Softverike, MSc, 120 ECTS; Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS; Infermieri, BA, 180 ECTS, dhe Inxhinieri Civile, MSc, 120 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Bazuar në nenin e referuar më sipër, KShC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, dhe pas shqyrtimit të të dhënave për secilin anëtar të stafit akademik, KShC mori vendim që të refuzojë aprovimin e aplikacioneve të Kolegjit Iliria për të gjitha programet e cekura në pikën një të dispozitivit të këtij vendimi.


Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Iliria për programet e studimit, Inxhinieri Softverike, MSc, 120 ECTS; Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS; Infermieri, BA, 180 ECTS, dhe Inxhinieri Civile, MSc, 120 ECTS, u konstatua që, Kolegji Iliria për këto programe të studimit nuk ka prezantuar asnjë staf akademik si bartës të këtyre programeve.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, dhe në mungesë të stafit akademik për programet e studimit, sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që këto program të studimit nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, Inxhinieri Softverike, MSc, 120 ECTS; Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS; Infermieri, BA, 180 ECTS, dhe Inxhinieri Civile, MSc, 120 ECTS.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Iliria”;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë